



Nr.148/2025

Datë: 30.06.2025

Agjencia për Informim dhe Privatësi, Zyrtari për Inspektim, duke vepruar në pajtim me nenin 68, nenin 69, paragrafi 1, dhe nenin 71, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1 dhe 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka kryer inspektim sipas detyrës zyrtare ndaj kontrolluesit “Dressame”, me NUI: 812177659 Sh.P.K dhe nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Urdhërohet** “Dressame”, me NUI: 812177659 Sh.P.K, të ndaloj përkohësisht përpunimin e të dhënave personale përmes sistemit të vëzhgimit me kamerë.
2. **Urdhërohet** kontrolluesi të bëjë shkatërrimin e të dhënave të mbledhura përmes sistemit të vëzhgimit me kamerë deri me datën e pranimi të këtij vendimi.
3. Kontrolluesi përpunimin e të dhënave personale përmes sistemit të vëzhgimit me kamerë mund ta bëjë vetëm pas plotësimit të kriterëve të parapara në nenin 75 dhe 76 të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
4. Obligohet kontrolluesi përpunimin e të dhënave personale ta beje në pajtim me Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
5. Obligohet kontrolluesi që brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga pranimi i këtij vendimi të ndërmerr të gjitha veprimet e duhura për zbatim të këtij vendimi dhe të njoftoj Agjencinë për Informim dhe Privatësi.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Agjencia për Informim dhe Privatësi (*Agjencia*), më datë 26.06.2025, bazuar në nenin 68, paragrafi 1, dhe nenin 69, të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDhP), ka realizuar inspektim sipas detyrës zyrtare “Dressame”, me NUI: 812177659 Sh.P.K ,lidhur me ligjshmërinë e përpunimit të dhënave personale përmes sistemit të vëzhgimit me kamerë. Gjatë inspektimit, është hartuar procesverbali me nr.16/25 dhe numër serik:00000083, datë 26.06.2025, me të cilin është konstatuar kjo gjendje faktike: Kontrolluesi ka të vendosur sistem të vëzhgimit me kamerë në hapësirën e brendshme të biznesit. Mungon shenja njoftuese (informuese) nuk posedon vendim të brendshëm për

vendosje sistemi të vëzhgimit. . Numri total i kamerave është një (1) copë. Afati i ruajtjes është në periudhë 10 ditore. Kontrolluesi deklaron se sistemi nuk është audio.

Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat ndëshkuese lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë së individit. Sipas nenit 3, paragrafi 1, (nënparagrafi 1.1) të LMDhP-së, me të dhëna personale nënkuptojmë çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm (“subjekt i të dhënave”); një person fizik i identifikueshëm është ai, i cili, mund të identifikohet drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, veçanërisht duke i’u referuar një identifikuesi në bazë të një emri, një numri identifikimi, të dhënave rreth vendndodhjes, një identifikues online, ose një apo më shumë faktorë specifikë për identitetin fizik, psikologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të atij personi fizik.

Në kontekstin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë së individit, vëzhgimi me kamerë nënkupton marrjen dhe ruajtjen e të dhënave vizuale ose të tjera nga vendet e vëzhguara, ku personat fizikë lëvizin, përmes sistemit të instaluar të vëzhgimit me kamerë.

Për më tepër, vëzhgimi me kamerë nënkupton përpunimin e të dhënave personale gjatë regjistrimit të një personi fizik, në përputhje me përkufizimin e përpunimit të të dhënave personale të parashikuara në LMDhP. Kur kemi të bëjmë me përpunimin e të dhënave personale, LMDhP në dispozitat e tij ka dhënë kuptimin se cilat veprime konsiderohen si përpunim i të dhënave personale, gjegjësisht neni 3, paragrafi 1, (nënparagrafi 1.2) të LMDhP-së, përcakton se me përpunim nënkuptojmë çdo veprim ose seri veprimesh që kryhen ndaj të dhënave personale me mjete automatike ose jo, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, publikimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja ose ofrimi, njësimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose asgjësimi. Në kuadër të kësaj dispozite, nënkuptojmë se mbledhja dhe regjistrimi i imazheve të marra nga sistemi i vëzhgimit me kamerë, përbënë përpunim të dhënave personale.

LMDhP parasheh parimet themelore për përpunimin e të dhënave personale që duhet respektohet me rastin e përpunimit të dhënave personale. Njëri ndër këta parime është parimi i ligjshmërisë, drejtësisë dhe transparencës, në bazë të të cilit të dhënat personale përpunohen në mënyrë të paanshme, të ligjshme dhe transparente, pa e cenuar dinjitetin e subjekteve të të dhënave. Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale është kur zbatohet së paku një nga kriteret e paraparë në nenin 5 të LMDhP-së, me të cilën kontrolluesi do të legjitimonte përpunimin e të dhënave, që nënkupton se të dhënat personale duhet të përpunohen vetëm në përputhje me ligjin.

Neni 75 paragrafi 2 i LMDhP-së përcakton se: personat që kanë për qëllim të vendosin sistemin e vëzhgimit me kamerë duhet të vendosin njoftim për këtë (shenjë paralajmëruese), i cili duhet të jetë i dukshëm dhe të bëhet publik në mënyrë që t’iu mundësojë subjekteve të të dhënave, që pa vështirësi, të njoftohen me masat, më së voni kur të fillojë vëzhgimi me kamerë dhe ky njoftim duhet të përmbajë të dhënat me të cilat do të identifikohet kontrolluesi i të dhënave.

Neni 76, paragrafi 1 i LMDhP-së, përcakton se personat në sektorin publik dhe privat mund të instalojnë sistemet e vëzhgimit me kamerë për vëzhgimin e ndërtesave të tyre nëse konsiderohet e nevojshme për sigurinë e njerëzve dhe sigurimin e pasurisë, nëse nuk mund të arrihet me mjete tjera më të lehta.

Vëzhgimi me kamerë, në veçanti mund të jetë i nevojshëm për të vëzhguar hyrjet e ndërtesave ose për shkak të natyrës së punës së tyre, ekziston kërcënimi potencial ndaj të punësuarve.

Neni 76, paragrafi 2 dhe 3 i LMDhP-së, përcakton se për instalimin e sistemit të vëzhgimit me kamerë, duhet merret vendim nga nëpunësi kompetent, drejtori ose ndonjë person tjetër i autorizuar nga sektori privat, i cili vendim duhet të përmbajë arsyet për vendosjen e sistemit të vëzhgimit me kamerë. Në pajtim me nenin 76, (paragrafi 5 dhe 7) të LMDhP-së, personat që punojnë në ndërtesat publike dhe private nënë vëzhgim me kamerë duhet të informohen në mënyrë të duhur në formë të shkruar për instalimin e sistemeve të tilla dhe të drejtat e tyre. Regjistrimet nga vëzhgimi i sistemit me kamerë, mund të ruhen deri në një (1) muaj, përveç nëse nuk kërkohen ndryshe për qëllime legjitime.

Kontrolluesi, me rastin e vendosjes së sistemit të vëzhgimit me kamerë, duhet të kujdeset që perimetri i vëzhgimit me kamerë të përfshijë pronën /hapësirën, e tij dhe mos të kaloj në pronë publike apo pronë të personave tjerë fizikë apo juridik.

Kontrolluesi, ka përpunuar të dhënat personale në kundërshtim nenin 75, paragrafin 2 të LMDhP-së, pasi që i njëjti nuk ka vendosur njoftimin (shenjën paralajmëruese), si dhe në kundërshtim me nenin 76, paragrafin 2 dhe 5, të LMDhP-së, duke mos nxjerrë vendim për instalimin e sistemit të vëzhgimit me kamerë dhe duke mos i njoftuar në mënyrë të duhur me shkrim personat që punojnë nën vëzhgimin me kamerë.

Agjencia për Informim dhe Privatësi pas inspektimit të kryer dhe vërtetimit të gjendjes faktike, bazuar në kompetencat e dhëna me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

[Nënshkruar më datë 30.06.2025]

Zyrtare për Inspektim

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej 30 ditësh. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- “Dressame” Sh.P.K,-Kontrolluesit,
- Arkivit të Agjencisë.